



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 20536 Prot

Lezhë, më 03.12.2025

VENDIM

Nr. 110, Datë 26. 11. 2025

PËR MIRATIMIN E PLANIT TEMATIK VJETOR TË KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË  
PËR VITIN 2026

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; neni 8, neni 53, neni 54 dhe neni 70, si dhe në Rregulloren e Këshillit të Bashkisë Lezhë e miratuar me Vendimin Nr. 54, datë 28.04.2020 të Këshillit Bashkiak, i ndryshuar, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

Vendosi :

1-Të miratojë Planin tematik vjetor të Këshillit të Bashkisë Lezhë për vitin 2026, sipas muajve:

➤ **JANAR**

- ❖ Mbledhje e Këshillit dhe Komisioneve të Përhershme
- ❖ Fillimi i procesit për krijimin e sekretariatit të Këshillit
- ❖ Fillimi i procesit të zgjedhjeve të strukturave komunitare në qytet
- ❖ Këshilli informohet dhe diskuton planin vjetor të prokurimit për të gjitha projektet e reja dhe ato në vazhdim të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë
- ❖ Shqyrtimi dhe miratimi i përdorimit të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike
- ❖ Vendimmarrje të tjera imediate për mbarëvajtjen e veprimtarisë administrative të Bashkisë
- ❖ Të ndryshme

➤ **SHKURT**

- ❖ Mbledhje e Këshillit dhe Komisioneve të Përhershme
- ❖ Informacion nga OSHEE mbi furnizimin me energji elektrike në Bashkinë Lezhë
- ❖ Këshilli informohet dhe diskuton raportin e katër mujorit të tretë, dhe njëkohësisht i dymbëdhjetë mujorit, mbi performancën e produkteve për secilin program të buxhetit vjetor të vitit paraardhës të Bashkisë të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, përfshirë raportin mbi të ardhurat e paarkëtuara
- ❖ Shqyrtimi dhe miratimi i raportit për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për dy vitet para vitit buxhetor, vitin buxhetor 2026 dhe tre vitet e ardhshme buxhetore 2027-2029
- ❖ Shqyrtimi dhe miratimi i përdorimit të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike
- ❖ Vendimmarrje të tjera imediate për mbarëvajtjen e veprimtarisë administrative të Bashkisë
- ❖ Të ndryshme

## ➤ **MARS**

- ❖ Mbledhje e Këshillit dhe Komisioneve të Përhershme
- ❖ Miratimi i taveve të shpenzimeve sipas programeve buxhetore për PBA-në 2027-2029 (Faza e Parë) të Bashkisë Lezhë
- ❖ Anketimi vjetor për vlerësimin nga komuniteti të punës dhe rezultateve të Këshillit (Familje, Biznese, të rinj)
- ❖ Hartimi i raportit të veprimtarisë vjetore të KB dhe transparencën në procesin e vendimmarrjes së Këshillit
- ❖ Shqyrtimi dhe miratimi i përdorimit të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike
- ❖ Vendimmarrje të tjera imediate për mbarëvajtjen e veprimtarisë administrative të Bashkisë
- ❖ Të ndryshme

## ➤ **PRILL**

- ❖ Mbledhje e Këshillit dhe Komisioneve të Përhershme
- ❖ Informacion për menaxhimin e mbetjeve dhe ofrimin e shërbimeve nga Bashkia Lezhë
- ❖ Shqyrtimi dhe miratimi i përdorimit të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike
- ❖ Vendimmarrje të tjera imediate për mbarëvajtjen e veprimtarisë administrative të Bashkisë
- ❖ Të ndryshme

## ➤ **MAJ**

- ❖ Mbledhje e Këshillit dhe Komisioneve të Përhershme
- ❖ Informacion për masat e marra për një sezon turistik sa më të suksesshëm.
- ❖ Këshilli informohet dhe diskuton raportin e parë katër-mujor mbi performancën e produkteve për secilin program të buxhetit vjetor të vitit korrent të Bashkisë të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, përfshirë raportin mbi të ardhurat e paarkëtuara
- ❖ Trajnim të Këshillit mbi Planin Vjetor dhe Buxhetimin si dhe zbatimin e Rregullores së Ankesave, Kerkesave, Nismave dhe Peticioneve
- ❖ Vizitë Studimore e Këshillit në dy njësi vendore (Korçë, Fushë Kosovë)
- ❖ Këshilli përmbyll dëgjuesat me publikun lidhur me tavanet e buxhetit për vitin 2027 dhe PBA 2027-2029
- ❖ Shqyrtimi dhe miratimi i përdorimit të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike
- ❖ Vendimmarrje të tjera imediate për mbarëvajtjen e veprimtarisë administrative të Bashkisë
- ❖ Të ndryshme

## ➤ **QERSHOR**

- ❖ Mbledhje e Këshillit dhe Komisioneve të Përhershme
- ❖ Analizë dhe informim për çështje të tatim-taksave të Bashkisë Lezhë.
- ❖ Informacion mbi masat e marra për kontrollin mbi territorin
- ❖ Analizë / informim i Bashkisë Lezhë mbi çështje të mbrojtjes civile (zjarre, përmbajtje, tërmete)
- ❖ Analizë mbi punën që është bërë nga administrata e bashkisë për zbatimin e vendimeve të Këshillit Bashkiak
- ❖ Bashkia dërgon në Këshill Buxhetin Faktik për 4-mujorin e parë
- ❖ Bashkia dërgon në Këshill për miratim projektin e parë të dokumentit të programit buxhetor afatmesëm PBA, duke marrë parasysh edhe mendimet e Ministrisë së Financave
- ❖ Këshilli zhvillon seanca të konsultimeve me publikun mbi rishikimin e buxhetit
- ❖ Shqyrtimi dhe miratimi i përdorimit të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike
- ❖ Vendimmarrje të tjera imediate për mbarëvajtjen e veprimtarisë administrative të Bashkisë
- ❖ Të ndryshme

## ➤ **KORRIK**

- ❖ Mbledhje e Këshillit dhe Komisioneve të Përhershme
- ❖ Analizë e çështjeve të arsimit nga Bashkia Lezhë si dhe objektivat për përgatitjen e vitit të ri mësimor
- ❖ Miratimi i tavanëve të shpenzimeve sipas programeve buxhetore për PBA-në 2027-2029 (Faza e Dytë) të Bashkisë Lezhë
- ❖ Informacion mbi realizimin e buxhetit për 6-mujorin e vitit 2026
- ❖ Shqyrtimi dhe miratimi i përdorimit të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike
- ❖ Vendimmarrje të tjera imediate për mbarëvajtjen e veprimtarisë administrative të Bashkisë
- ❖ Të ndryshme

## ➤ **GUSHT**

- ❖ Mbledhje e Këshillit dhe Komisioneve të Përhershme
- ❖ Informacion mbi realizimin e buxhetit për 7-mujorin e vitit 2026
- ❖ Shqyrtimi dhe miratimi i përdorimit të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike
- ❖ Vendimmarrje të tjera imediate për mbarëvajtjen e veprimtarisë administrative të Bashkisë
- ❖ Të ndryshme

## ➤ **SHTATOR**

- ❖ Mbledhje e Këshillit dhe Komisioneve të Përhershme
- ❖ Bashkia dërgon në Këshill Buxhetin Faktik për 4-mujorin e dytë
- ❖ Bashkia dërgon në Këshill për miratim fazën e dytë të dokumentit të programit buxhetor afatmesëm PBA
- ❖ Vizitë Studimore jashtë Shqipërisë (Hollandë ose Maqedoni e Veriut)
- ❖ Hartimi i Planit Vjetor të Punës së KB Lezhë
- ❖ Hartimi i Buxhetit të KB Lezhë
- ❖ Shqyrtimi dhe miratimi i përdorimit të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike
- ❖ Vendimmarrje të tjera imediate për mbarëvajtjen e veprimtarisë administrative të Bashkisë
- ❖ Të ndryshme

## ➤ **TETOR**

- ❖ Mbledhje e Këshillit dhe Komisioneve të Përhershme
- ❖ Informacion mbi realizimin e buxhetit për 9-mujorin e vitit 2026
- ❖ Informacion mbi mbarëvajtjen e sezonit turistik, realizimin e treguesve në fushën e turizmit dhe propagandimit të vlerave muzeale
- ❖ Shqyrtimi dhe miratimi i përdorimit të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike
- ❖ Vendimmarrje të tjera imediate për mbarëvajtjen e veprimtarisë administrative të Bashkisë
- ❖ Të ndryshme

## ➤ **NËNTOR**

- ❖ Mbledhje e Këshillit dhe Komisioneve të Përhershme
- ❖ Shqyrtimi dhe miratimi i Paketës Fiskale
- ❖ Këshilli merr nga Kryetari i Bashkisë projekt dokumentin përfundimtar të programit buxhetor afatmesëm PBA dhe të projekt-buxhetit vjetor
- ❖ Këshilli zhvillon seanca të konsultimeve me publikun për projekt dokumentin e programit buxhetor afatmesëm dhe të projekt-buxhetit vjetor përfshirë Planin Vjetor
- ❖ Informacion mbi realizimin e buxhetit për 10-mujorin e vitit 2026
- ❖ Shqyrtimi dhe miratimi i hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara në vijën bregdetare të Bashkisë Lezhë
- ❖ Shqyrtimi dhe miratimi i përdorimit të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike
- ❖ Vendimmarrje të tjera imediate për mbarëvajtjen e veprimtarisë administrative të Bashkisë
- ❖ Të ndryshme

➤ **DHJETOR**

- ❖ Mbledhje e Këshillit dhe Komisioneve të Përhershme
  - ❖ Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit të vitit 2027 dhe PBA 2027-2029
  - ❖ Shqyrtimi dhe miratimi i trajtimit me bursë të nxënësve të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2026-2027
  - ❖ Vizitë studimore jashtë vendit Itali
  - ❖ Shqyrtimi dhe miratimi i përdorimit të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike
  - ❖ Vendimmarrje të tjera imediate për mbarëvajtjen e veprimtarisë administrative të Bashkisë
  - ❖ Të ndryshme
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Kryesia e Këshillit të Bashkisë Lezhë.
  3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ**



**KRYETARI  
NDUE LULI**





REPubLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1191/6 Prot.

Lezhë, më 10.12.2025

Lënda: **Konfirmim vendimi**

**KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË**

Për Dijeni : **KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË**

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr.107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut"; nenin 54 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.110, datë 26.11.2025 të këshillit të bashkisë Lezhë "Për miratimin e planit tematik vjetor të Këshillit të Bashkisë Lezhë për vitin 2026".

**P R E F E K T I**

**Taulant MALSHI**

